

Udhëzime për raportimin profesional të vaksinave COVID-19

Një raport i ri nga Qendra për Luftimin e Urrejtjes Dixhitale në SHBA ka kritikuar fort kompanitë e mediave sociale për lejimin që lëvizja anti-vaksinë të vazhdoje te qendroje në platformat e tyre. Autorët e raportit vunë në dukje se llogaritë e mediave sociale të të ashtuquajturve anti-vaxxers kanë rritur ndjekësit e tyre me të paktën 7 - 8 milion njerëz që nga 2019. "Vendimi për të vazhduar me lejimin e përmbajtjeve dhe aktorëve të njohur cinformues i la anti-vaxxers në internet të gatshëm të shfrytëzonin mundësitë e paraqitura nga koronavirusi," thuhej në raport. Qendra paralajmëroi se lëvizja në rritje anti-vaksinë mund të minojë shpërndarjen e çdo vaksine kundër COVID-19 në të ardhmen. Raporti nënvizoi se 31 milion njerëz ndjekin grupet anti-vaksina në Facebook, ndërsa 17 milion njerëz abonohen në llogari të ngjashme në YouTube.

Qëndrimet e publikut ndaj vaksinimit mund të ndahen në tri kategori. Së pari, ka njerëz që janë bindur për dobitë e vaksinimit. Në Mbretërinë e Bashkuar dhe në SHBA, ky grup përbën diku midis 70% dhe 90% të popullsisë. Së dyti, janë anti-vaxxers dogmatikë. Këta janë njerëz në skaje. Ata nuk do t'i ndryshojnë pikëpamjet e tyre, edhe në mes të pandemisë. Midis dy grupeve qëndron një i tretë që përbëhet nga njerëz që janë të pavendosur. "Këta njerëz kanë pyetje legjitime," thotë një ekspert i njohur i komunikimit. "Ata duan të bëjnë gjënë e duhur, por kanë dyshime. Këtu duhet të përqendrojmë vëmendjen tonë."

Lëvizja kundër vaksinave duket sikur tashmë e ka kuptuar këtë. Një shkrim i botuar në Nature më herët këtë vit analizoi pikëpamjet që qarkullojnë në internet për vaksinimin. Autorët arritën në përfundimin se "megjithëse janë pak në numrin e përgjithshëm, grupet anti-vaksinuese arrijnë të përziehen fort me grupet e pavendosura në Internet, ndërkohë që grupet pro-vaksinimit qëndrojnë më në periferi". Ata paralajmëruan se në një dekadë lëvizja kundër vaksinimit mund të tejkalojë zërat pro-vaksinimit në internet. Nëse kjo do të ndodhte, pasojat do të shtriheshin përtej COVID-19.

Ndërsa debatet aktualisht janë fokusuar tek shpërndarja e vaksines dhe tek afatet e fillimit të vaksinimit në vende të ndryshme, përfshirë vendet e vogla si Shqipëria, pyetjet e natyrshme dhe konspiracionet e zakonshme vazhdojnë të gjallojnë në media, sidomos në internet.

Faktet kryesore ende të panjohura për vaksinat e ndryshme kandidate përfshijnë:

- Nëse - dhe me sa - zvogëlojnë rrezikun e shtrimit në spital ose pranimin në kujdes intensiv;
- Nëse - dhe sa - ato zvogëlojnë rrezikun e transmetimit;
- Sa i mbrojnë ato grupet më vulnerabël, si të moshuarit;
- Sa funksionojnë tek fëmijët dhe adoleshentët;
- Sa funksionojnë në njerëz me imunitet të kompromentuar;
- Sa efektive do të jenë ato pas tre, ose gjashtë, ose 12 muajsh - duke pasur parasysh që, në vaksinat e tjera si ato për gripin, përgjigja imune mund të bjerë me kalimin e kohës.

Ndersa keto pyetje janë legjitime, gazetaret që raportojne per keto tema duhet te kene parasysh disa keshilla dhe udhezime te hartuara nga ekspertet e medias dhe te shendetit. Me më shumë se 100 vaksina aktualisht në faza të ndryshme prove dhe disa që arrijnë fazën e para-aprovimit ose janë të autorizuara për përdorim urgjent, raportimi i saktë shkencor nuk ka qenë kurrë më i rëndësishëm. Gazetarët luajnë një rol jetik në informimin e publikut mbi shkencën, konkretisht rreth zhvillimeve mbi vaksina, në një periudhë të paprecedent të botimeve shkencore.

Situata është në zhvillim e sipër, por ka disa udhëzime të përgjithshme që duhet të ndiqen kur është e mundur:

Mos raportoni vetëm titujt

Lexoni studimin ose raportin e plotë përpara se të botoni një artikull në lidhje me të. Gjetjet në përmbledhjen e një studimi mund të mos jenë vërtet treguese të gjetjeve të studimit të plotë. Revistat mjekësore po rishikojnë dhe botojnë raporte më shpejt sesa bëjnë normalisht, kështu që të dish të lexosh në mënyrë kritike është thelbësore për raportimin e saktë të gjetjeve të tyre.

Mos raportoni duke u bazuar vetëm në një njoftim për shtyp. Gjithmonë lexoni studimin e plotë ose raportin e hulumtimit.

Mos u besoni automatikisht të dhenave

Jini të vetëdijshëm dhe të gatshëm për të vene ne pikepyetje palët e interesuara dhe metodologjinë e mbledhjes së të dhënave. Kërkoni të dhënat e papërpunuara kur është e mundur dhe gjithmonë përfshini detajet e metodave të kerkimit në raportimin tuaj.

Përdorni burime të besueshme

Raportimi është po aq i mirë sa burimet e tij. Sigurohuni që të përdorni burime kompetente për t'i patur si burim per lajmet tuaja mbi COVID-19 dhe vaksinat.

Kur raportoni për një vaksinë ose studim të ri, konsultohuni me ekspertet e medias dhe te shkences, për te marre vlerësimet e tyre mbi zhvillimet e fundit.

Përmendni burimin

Kur raportoni për studime shkencore, raporte, numra të rasteve dhe vaksinat, përmendni burimin e informacionit për të treguar besueshmëri dhe per t'i lejuar lexuesit të kërkojnë më shumë informacion mbi temën.

Definoni termat

Megjithëse disa fjalë shkencore mund të përdoren shpesh në raportimin e COVID-19 dhe vaksinave, është e rëndësishme të definohen termat shkencorë në çdo artikull, ose të bashkëngjisni [një fjalor termash](#) që do të lejojnë lexuesin të edukoje vetveten.

Përdorni një gjuhë të qartë

Shumica e lexuesve nuk do të jenë familiare me gjuhën shkencore. Disa terma mund të definohen brenda artikullit, por bëni një përpjekje për t'i formuluar shpjegimet në terma të thjeshtuar në mënyrë që lexuesit e të gjitha niveleve të kuptojnë.

Shpjegoni skenën

Disa kerkime mund të tregojnë rezultate interesante bazuar vetëm në një grup paraprak të të dhënave. Kontrolloni nëse një raport ose studim është recensionuar dhe sigurohuni që shkrimi juaj të thotë në cilën fazë është. Studimet në faza fillestare nuk duhet të raportohen si të barabarta me studimet e pranuar nga një revistë shkencore.

Raportoni numrat

Ka dhjetëra vaksina në faza të ndryshme të zhvillimit në çdo kohë të caktuar. Kur raportoni për një vaksinë ose studim, është e rëndësishme të specifikoni madhësinë, numrat e testuar dhe periudhën kohore të provës.

Raportoni efektet anësore

Asnjë vaksinë në histori nuk ka përparuar përmes provave klinike dhe paraaprovimit aq shpejt sa vaksinat e fundit COVID-19. Shpjegimi i qartë i efekteve anësore të mundshme të çdo vaksine dhe raportimi mbi efektet anësore të përjetuara nga pjesëmarrësit në provat klinike do të ndihmojë në informimin e publikut dhe lehtësimin e hezitimeve të tij mbi vaksinën.

Përdorni imazhe të përshtatshme

Zgjedhja e ilustrimeve në artikujt rreth vaksinave është e rëndësishme. Vaksinat nuk janë diçka për t'u frikësuar, prandaj shmangni pamje të tilla si foshnja që qajnë, pacientë me pamje ankthi dhe gjilpëra të mëdha. Sigurohuni që ilustrimet të përfaqësojnë të gjithë lexuesit, duke treguar një sërë njerëzish që punojnë, administrojnë dhe marrin vaksina.

Mos harroni demografinë

Jo çdo vaksinë do të jetë një lloj efektive në të gjitha popullatat. Kur raportoni për efikasitetin e një vaksine në provat klinike, vini re demografinë e pjesëmarrësve në provë.

Kujtojuani të gjithëve përfitimet e vaksinave

Raportimi mbi vaksinat potencialisht efektive COVID-19 është jetik për informimin e atyre që tashmë planifikojnë të vaksinohen, por me keqinformimin e përhapur gjatë pandemisë, mos harroni të informoni lexuesit për rëndësinë e të gjitha vaksinave.

Trajtoni hezitimin e vaksinimit duke raportuar fakte dhe shifra mbi efikasitetin e vaksinave në dhënien fund të epidemive përgjatë historisë.